



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborui Panel za žalbe i Predstavke

ZL Anr.1119/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtar, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur lidhur me apelin e kandidatit për kryetar të Komunës së Kamenicës, Shaip Surdulli nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Kamenicë, paraqitur kundër vendimit Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për shpalljen e rezultatit përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale, për Raundin e dytë, për Kryetar të Komunës, për shkak të ligjshmërisë së kandidaturës për kryetar të Komunës së Kamenicës, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 01.12.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET SI I PASAFATSHM apeli i kandidatit për kryetar të Komunës së Kamenicës, Shaip Surdulli, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Kamenicë, me shenjën ZL.Anr.1119/2017 i datës 30.11.2017, kundër vendimit Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për shpalljen e rezultatit përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale, për Raundin e dytë, për Kryetar të Komunës, për shkak të ligjshmërisë së kandidaturës për kryetar të Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati nga radhët e subjektit politik LVV, për Zgjedhjet Lokale 2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 30.11.2017, ka pranuar një ankesë nga Kandidati për Kryetar të Komunës së Kamenicës Shaip Surdulli nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), paraqitur kundër vendimit Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për shpalljen e rezultatit përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale, për Raundin e dytë, për Kryetar të Komunës së Kamenicës, paneli e ka trajtuar ankesën dhe procedura në këtë fazë të procesit zgjedhor si apel, në kuptim të dispozitës ligjore të nenit 3 par.8 Rregullës Nr.02/2015, të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it. Sipas nenit 2 të Rregullës Nr.02/2015, të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Apel do të thotë mjetë i rregullt juridik, kundër vendimeve të organit të shkallës së parë, siç është KQZ-ja, në këtë rast, lidhur me nenin 122 të LZP-së.

Parashtruesit e apelit, Kandidati për Kryetar të Komunës së Kamenicës Shaip Surdulli nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, ku pretendon se kandidati për kryetar të

Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati nga radhët e subjektit politik LVV, është certifikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në kundërshtim me dispozitën e nenit 9.2 të Ligjit Nr. 03/L-072, pasi që kandidati në fjalë ka qenë banor në Komunën e Prishtinës, pa qenë banor së paku 3 vite në Komunën e Kamenicës, këtë kusht nuk e ka plotësuar. Po ashtu, Valon Maliqi drejtor i Administratës Komunale, tani nënkryetar i Komunës së Kamenicës, e ka lajmëruar rastin në ARC, një ditë para certifikimit të kandidatëve për kryetar të Komunave të Republikës së Kosovës nga KQZ-ja, më datë 21.08.2017. Regjistrimi i Qendron Kastratit, si banor në Komunën e Kamenicës është bërë në kundërshtim me nenin 5.3 dhe 6.3 të Ligjit Nr. 02/L-121 për Vendbanimin dhe Vendqëndrimin, pasi që ndërrimi i vendbanimit është bërë pa prezencën e personit në fjalë dhe pa dëshmi. Kërkon nga paneli që të vlerësoj ligjshmërinë e kandidaturës të Qendron Kastratit për kryetar të Komunës së Kamenicës dhe me që kjo është bërë në mënyrë të kundërligjshme, ti anuloj zgjedhjet për kryetar të Komunës së Kamenicës. Apelit i ka bashkangjitur Fletëregjistrimin e datës 21.08.2017, email i drejtorit të Administratës Komunale, Vërtetimi për lajmërimin/çlajmërimin e vendbanimit/vendqëndrimit i datës 21.08.2017 dhe Vërtetimi i datës 21.08.2017.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të afatshmërisë së apelit, gjeti se: **Apeli është i pasafatshëm**

Pas përfundimit të procedurave për aplikim për certifikim, KQZ-ja me vendimin nr. 1545/3-2017 të datës 30.08.2017, ka miratuar rekomandimin e Zyrës për Certifikimin e Partisë Politike, Lëvizja Vetëvendosje për pjesëmarrjen në Zgjedhje Lokale, me kandidatët për kryetar të Komunave dhe kandidatët për anëtar të Kuvendeve Komunale me gjithsejtë 875 (tetëqind e shtatëdhjetë e pesë) kandidatë nga subjekti politik LVV, në mesin e këtyre kandidatëve është edhe Qëndron Kastrati, kandidatë për Kryetar të Komunës së Kamenicës. Afati për paraqitjen e ankesës kundër këtij vendimi ka qenë deri më datë 04.09.2017, dhe ndaj këtij vendimi palët nuk kanë ushtruar ankesë që do të thotë se ankesa është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me nenin 26.6 të LZP-së i cili përcakton se: *“Ankesa e cilit do subjekt politik ndaj vendimit të KQZ-së për të refuzuar certifikimin e listës së kandidatëve tek PZAP-i bëhet brenda afatit prej pesë (5) ditë pune pas njoftimit të atij subjekti politik me vendimin”*.

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë në kuptim të nenit 118, neni 26.6 të LZP-së si dhe neni 11.5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr.1119/2017 më datën 01.12.2017

Kryesues i Panelit

Hasan Shala



Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.*